



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1215 /8 prot.

Datë 27 .04.2026

V E N D I M
Nr. 555 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27. 04.2026, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër. 1215/2026 prot., datë 21.04.2026 për procedurën “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 8,245,000.00 lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 07-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

Ankimues: Operatori ekonomik “Koloseu” shpk me NIPT J72603129H, Adresa: Rruga Lagjja 18 Shtatori ,pallat 8-katësh, pranë qendres.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Shërbimeve Publike Berat, Adresa: Rruga Baki Gjebrea , Berat.

Subjekte të Interesuara: Operatorët ekonomik “Anadea” shpk, me NIPT L87201401H, Adresa: Shupenzë, Bulqizë.

“Ervin Luzi” pf, me NIPT K71707007Q, Adresa: Kashar, Yrshek, Rruga “Ali Pashë Guci”.

“Sali Elektrik” shpk, me NIPT K72217008P, Adresa: Lagjja Shkozet, km 2 autostrada Tiranë - Durrës.

“Qamil Doka” pf, me NIPT L81924026A, Adresa: Rruga: “Kadillari”, Dyqan dhe Magazin Nr47 .

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nen kufirin e ulet monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19-02-2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 8,245,000.00 lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 07-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

II.2. Në datën 10.04.2026 është berë vlerësimi për procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin e ofertave si vijon:

1.EKM Konstruksion & Teknologji	4,972,000 lekë
2.Ozzi Group	5.430.000 lekë
3.ANADEA SHPK	5.774.000 lekë
4.Sali elektrik shpk	5.895.722 lekë
5.Ervin Luzi pf	6.183.750 lekë
6.“ISEC” sh.p.k.	7.000.000 lekë
7.Sofia Myftari pf	7,158,000 lekë
8.Xheris Company shpk	7 644 510 lekë
9.Qamil Doka PF	7,683,500 lekë
10.“KOLOSEU” shpk	7.723.000 lekë
11.Mifeel shpk	7,886,000 lekë
12.Keta elite shpk	pa oferte
13. Shkodra eleketrike	pa oferte

II.3. Në datën 17.04.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Publikimin e Njoftimit e e fituesit paraprak për procedurën e prokurimit.

II.4. Me datë 24.04.2026 autoriteti kontraktor ka depozituar informacion lidhur me trajtimin ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik , ku vendosi mospranimin e saj.

II. 5. Me datë 24.04.2026 Operatori ekonomik “Anadea” SHPK, protokolluar me tonën me nr. 1215/4 dhe 1215/5 “formular argumentash”.

II.6. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me është administruar ankesa e ardhur me nr. 1215 prot., datë 21.04.2026 nga operatori ekonomik “Koloseu” shpk për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 8,245,000.00 lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 07-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga “Anadea” shpk, “Ervin Luzi” pf, “Sali Elektrik” shpk, “Qamil Doka”pf, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), është hartuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1215/1 datë 22.04.2026, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Në datën 24.04.20265 , operatori ekonomik ankimes “Koloseu” shpk, ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike shkresën protokolluar me tonën Nr.1215/2 protokolluar me tonën, drejtuar Komisionit, “Shoqëria “KOLOSEU” sh.p.k., me NIPT J72603129H, me adresë në Berat Ura Vajgurore, në cilësinë e ankimesit në procedurën e prokurimit me nr. reference REF-76569-02-18-2026, me objekt “Blerje materiale elektrike”, paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik njëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, Njëpërmjet kësaj kërkesë, deklaroi se heq dorë nga ankesa e paraqitur dhe kërkon tërheqjen e saj, për arsye ekonomike dhe se shoqëria “KOLOSEU” sh.p.k është e angazhuar në kontrata të tjera, dhe për këto arsye nuk ka më interes në vijimin e mëtejshëm të procedurës së shqyrtimit. Duke qenë se ankesa është paraqitur nga ana jonë në mënyrë vullnetare, tërheqja e saj bëhet gjithashtu në mënyrë të lirë dhe të vetëdijshme. Për sa më sipër, kërkojmë pranimin e kësaj kërkesë tërheqje. Data 22.04.2026 Për shoqërinë “KOLOSEU” sh.p.k. Administratori Jani QOSJA.”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “KOLOSEU” sh.p.k., për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit , “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 8,245,000.00 lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 07-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet: “1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës. 2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues “KOLOSEU” sh.p.k, për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 1215/2026.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6569, protokolluar në datën 21.04.2026 me nr. 1215/2026 protokolli, e operatorit ekonomik “KOLOSEU” sh.p.k për procedurën e prokurimit , “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76569-02-18-2026, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 8,245,000.00 lekë pa tvsh , zhvilluar me datë 07-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KOLOSEU” sh.p.k.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

